

REGJISTRI I KERKESAVE DHE PERGJGJEVE PER VITIN 2024

Periudha (korrik-gusht-shtator)

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundi mit të kërkesës	Tarifa
17	20.06.2024	<p>1. Cili ka qenë numri i turistëve që kanë vizituar Belshin në vitet e fundit? A ka pasur një rritje apo ulje të numrit të turistëve vit pas viti? 2. Cilat janë grupet demografike që vizitojnë më shpesh Belshin? (mosha, gjinia, vendi i origjinës, etj.) 3. A ka ndonjë periudhë specifike të vitit kur këto grupe vizitojnë më shumë zonën? 4. Cilat janë faktorët kryesorë që shtojnë turistët të vizitojnë Belshin? (p.sh., natyra, kulturë, aktivitete sportive, gastronomia, etj.) 5. Çfarë lloj aktivitete turistike janë më të njohura në zonë? (p.sh., ecje në natyrë, shëtitje me varkë, peshkim, etj.) 6. Çfarë përpjekjesh ka bërë bashkia për të promovuar turizmin në Belsh?</p>	09.07.2024	<p>1. Në vitet e fundit, numri i turistëve që vizitojnë Belshin ka qenë gjithmonë në rritje. Vitin e kaluar, kemi pasur rreth 30,000 turistë që kanë vizituar këtë zonë. Ky trend pozitiv është dëshmi e tërheqjes së vazhdueshme që Belshi ka për turistët.</p> <p>2. Turistët që vizitojnë Belshin janë vendas dhe të huaj, dhe në shumicën e rasteve janë grupe familjare të të gjitha moshave. Ky diversitet tregon se Belshi është një destinacion i përshtatshëm për të gjitha grupmoshat dhe preferencat.</p> <p>3. Sezoni më i preferuar për të vizituar Belshin është pranvera. Gjatë kësaj periudhe, natyra është në lulëzim të plotë dhe klima është e këndshme, duke e bërë përvojën e vizitorëve edhe më të kënaqshme.</p> <p>4. Faktorët kryesorë që shtojnë</p>	E plotë	Pa pagesë

				<p>turistët të vizitojnë Belshin janë natyra e mrekullueshme e zonës, e cila përfshin liqene të shumta dhe kodra të bukura. Për më tepër, pozita gjeografike e Belshit dhe afërsia me qytetet kryesore e bëjnë atë të lehtë për t'u vizituar.5. Aktivitetet më të pëlqyera nga turistët në Belsh janë ato që lidhen me liqenet, si shëtitjet me varkë. Këto aktivitete ofrojnë një mënyrë të shkëlqyer për të shijuar natyrën dhe për të kaluar kohë cilësore me familjen dhe miqtë.6. Bashkia e Belshit ka vite që është fokusuar në zhvillimin e turizmit të zonës dhe promovimin e tij. Janë bërë investime të shumta në këtë sektor dhe është marrë pjesë në disa projekte të turizmit kombëtar dhe ndërkombëtar. Për shembull, Belshi është bërë pjesë e Green Destinations, një organizatë ndërkombëtare për promovimin e turizmit të qëndrueshëm.</p>		
18	09.07.2024	1. Të më vendoset në dispozicion Plani i Veprimit për Eficiencën e Energjisë, në bashkinë tuaj.2.	17.07.2024	Përsa i përket pikes 1 dhe 2, bashkia Belsh nuk ka të hartuar një Plan Veprimi të mirëfilltë për	E plotë	Pa pagesë

		<p>Cilat janë hapat e ndërmarrë për zbatimin e këtij plani (buxheti në dispozicion, aktivitete, politika, etj.).3.Nëse ky dokument nuk është hartuar ende, cilat janë arsyet?4.Çfarë hapash parashikohet të ndërmerren në të ardhmen për zbatimin/hartimin e Planit të Veprimit për Eficiencën e Energjisë?</p>		<p>Eficiencën e Energjisë dhe si rrjedhojë nuk ka një buxhet të dedikuar në dispozicion, aktivitete apo politika të hartuara për këtë. Përsa i përket pikes 3, Plani i Veprimit për Eficiencën e Energjisë nuk është hartuar ende për mungesë fondesh dhe mungesës së stafit të dedikuar posaçërisht për këtë.Përsa i përket pikes 4, po punohet për hartimin e Planit të Veprimit për Eficiencën e Energjisë, dhe gjithashtu ne planifikimet e bashkisë është edhe ndërtimi i impjantit fotovoltaik 350 kw i cili do të mbulojë nevojat për ndriçimin publik por edhe për institucionet</p>		
19	16.07.2024	<p>Kërkim informacioni mbi pyllëzimet e kryera nga subjektet që operojnë në energjinë hidrike HEC në territorin e bashkisë suaj nga viti 2008 e deri më sot, përkatësisht për pyetjet e mëposhtme:1.Sa sipërfaqe janë pyllëzuar?2.Në cilat parcela dhe ekonomi pyjore është bërë investimi?3.A ka patur investime të tjera përveç pyllëzimeve?</p>	17.07.2024	<p>Në bashkinë Belsh nuk ka subjekte që operojnë në energjinë hidrike HEC, mbi pyllëzimet e kryera, nga viti 2008 e deri më sot dhe si rrjedhojë nuk ka aktivitete apo investime të tjera të kryera në parcela apo ekonomi pyjore por edhe në fusha të tjera.</p>	E plotë	Pa pagesë

		Nëse po, ku dhe çfarë investimi?				
20	03.08.2024	<p>1. Keni ambiente publike me “free WiFi” në bashkinë tuaj? 2. Nëse përgjigja 1), është Po, në sa zona të bashkisë ka “free WiFi”? 2.1 Nëse përgjigja 1), është Po, cilat zona të bashkisë janë të mbuluara me “free WiFi”? 3. Nëse përgjigja 1), është Jo, a keni plane për investim në zona me “free WiFi”? 3.1. Cilat zona doni/mendoni se duhen të mbulohen me shërbim “free WiFi”?</p> <p>4. Jepni të dhëna për zonat që mendoni të keni më “free WiFi”?</p> <p>5. Nëse keni diçka tjetër për të shtuar lutem plotësoni.</p>	08.08.2024	<p>1. Jo.</p> <p>2.1 a) sheshe publike b) park/parqe c) stacione/terminale autobuzi d) pika turistike e) tjetër</p> <p>3. Po, e kemi në planë për investim në disa zona me “free WiFi”.</p> <p>3.1. a) sheshe publike : Shëtitorja rreth liqenit Belsh b) park/parqe c) stacione/terminale autobuzi d) pika turistike: Zona e Dumrea Eco Park dhe Magazinat (Depot) në Seferan e) tjetër</p> <p>4. a) Sipërfaqja e përafërt e zonës :</p> <p>1. Shëtitorja rreth liqenit Belsh – 0.06 km²</p> <p>2. Zona e Dumrea Eco Park – 0.30 km²</p> <p>3. Magazinat (Depot) në Seferan – 0.01 km²</p> <p>b) Rrezja e mbulimit c) Përdorues potencial në orë piku (nr. I përafërt përdorues të njëkohshëm)</p> <p>1. Shëtitorja rreth liqenit Belsh – 300 përdorues</p> <p>2. Zona e Dumrea Eco Park – 150 përdorues</p> <p>3. Magazinat (Depot) në Seferan – 100 përdorues</p>	E plotë	Pa pagesë

21	07.08.2024	A janë marrë masa në territorin e njësisë suaj të vetëqeverisjes vendore për identifikimin e individëve apo familjeve të minoritetit Rom dhe Egjiptian të paregjistruar në regjistrin e gjendjes civile duke u privuar kështu nga përfitimi i shërbimeve bazë si ndihma sociale, strehimi, arsimit, dhe shërbimet e tjera publike?	08.08.2024 4	Lidhur me iniciativën e ndërmarrë nga ana juaj për ndjekjen e problematikës së mosregjistrimit të pjesëtarëve të minoritetit Rom dhe Egjiptian në regjistrat e gjendjes civile në njësitë vendore ku ata kanë vendbanimin aktual, bashkia Belsh dhe zyra e gjendjes civile janë angazhuar për identifikimin e individëve apo familjeve që paraqesin këtë problematikë. Zyra e gjendjes civile Belsh gjatë këtij procesi nuk ka konstatuar asnjë rast ku individë apo familje të komunitetit Rom dhe Egjiptian kanë qenë të paregjistruar në regjistrin e gjendjes civile. Të gjithë individët apo pjesëtarë të familjeve të cilët i përkasin minoritetit Rom dhe Egjiptian nuk janë të privuar nga përfitimi i shërbimeve bazë si ndihma sociale, strehimi, dhe shërbimet e tjera publike.	E plotë	Pa pagesë
22	23.09.2024	1-Kopje ose link te Planit Social ose Strategjise per te rinjte per te rinjte ne bashkine tuaj(nese ka). 2-Liste te investimeve nga buxheti i bashkise kushtuar te rinjve ne	27.09.2024 4	1-Bashkia Belsh ende nuk ka të hartuar një Plan Social ose Strategjik për të rinjtë. 2-bashkia Belsh nuk ka një listë të investimeve pasi në territorin e bashkisë Belsh nuk janë bërë	E plotë	Pa pagesë

		<p>territorin e bashkise tuaj.</p> <p>3-Zera ne buxhet nese e keni te vecuar per aktivitetete rinore sensibilizuese(Link ose dokument te Buxhetit ku pasqyrohen keto fonde).</p> <p>4-Plani per investime per te rinjte ne vitin 2025(nese eshte parashikuar dokument ose link).</p>		<p>investime të mirëfillta kushtuar të rinjve.</p> <p>3-Bashkia nuk ka të veçuar në buxhet zëra për aktivitetet rinore sensibilizuese, por gjatë vitit 2024 planifikoi në buxhet shumën prej 1.000.000 lekësh për disa aktivitete kombëtare të organizuara nga vetë të rinjtë por edhe nga shkollat duke bërë të mundur mbulimin e shpenzimeve për të rinjtë pjesëmarrës.</p> <p>4-Përsa i përket pikes 4, për vitin 2025 bashkia nuk ka bërë ende një plan për investime për të rinjtë por ka të përfshirë në prioritetet e saj në të ardhmen projekte dhe investime të cilat do të jenë në mbështetje të të rinjve si psh:-Projekti për ndërtimin e qendrës së re multifunksiionale Belsh, i cili synon hapjen e qendrës multifunksiionale në qytetin e Belshit dhe hartimin e programeve dhe aktiviteteve për funksionimin e tyre me fokus të veçantë të rinjtë. Projekti kontribuon edhe në trajtimin e nevojave të të rinjve të kësaj bashkie dhe synon të nxisë ndërveprimin social dhe pasqyrimin e vlerave dhe talenteve të</p>		
--	--	--	--	---	--	--

				<p>tyre.-Gjithashtu edhe një nga sfidat e bashkisë në të ardhmen e cila do t'iu vijë në ndihmë të rinjve është edhe krijimi i laboratorëve funksionalë të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në shkollë, duke siguruar që nxënësit të kenë akses në burimet teknologjike të nevojshme për zhvillimin e tyre arsimor dhe përgatitjen për tregun e punës.</p>		
--	--	--	--	--	--	--